



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPLLJE PER PLOTESIMIN E VENDEVE TE LIRA PER KATEGORINE E ULËT DREJTUESE

Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave në Drejtorinë e Planifikimit të Frekuencave dhe Teknologjisë së Informacionit.

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lire të kategorisë së ulët drejtuese:

- Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave - Kategoria e pagës III-A

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë ku mund të marrin pjesë për konkurrim edhe kandidatët jashtë shërbimit civil.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PER LEVIZJE PARALELE: **20 Prill 2017**

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PER NGRITJE DHE APLIKIMI NGA JASHTË SHERBIMIT CIVIL: **25 Prill 2017**

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Organizon dhe mbikqyr punën për optimizimin e spektrit të frekuencave për të siguruar numrin maksimal të mundshëm të frekuencave të lira, veçanërisht në zonat me numër të limituar të frekuencave të lira.
- Organizon punën për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave audio/audiovizive.
- Organizon dhe mbikqyr procesin e studimit për realizimin e planit të mbulimit sipas zonave përkatëse të subjekteve të licencuara mbështetur në ndarjen administrative të territorit të RSH.
- Verifikon në programin kompjuterik çdo studim të kryer lidhur me karakteristikat teknike dhe miraton apo ndryshon karakteristikat duke dhënë argumentim teknik për të kryer këtë ndryshim.
- Verifikon llogaritjet e kryera në programin kompjuterik lidhur me % e mbulimit të territorit me sinjal audio/audioviziv dhe nivelin e interferencave (të brendshme apo të jashtme) nga rrjete të tjerë ekzistues dhe të planifikuar.
- Mbikqyr zbatimin e procedurave të notifikimit dhe koordinimit me vendet fqinjë sipas udhëzimeve dhe në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga AMA.
- Mbikqyr në mënyrë periodike përditësimin e bazës së të dhënave me karakteristikat teknike të transmetimit audio dhe audioviziv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-A);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, profili Inxhinjeri. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë e të njëjtës fushë.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në nivel ekzekutiv.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim
- fotokopje të diplomës;
- fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi; Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 20 Prill 2017.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Në datën 24 Prill 2017, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi VKM Nr. 292, date 2.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”.
- Njohuri mbi VKM Nr. 466, date 27.02.2013 “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave”.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pike), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Ngritja në detyrë dhe pranimi nga jashtë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë apo pranimit nga jashtë për kategorinë e ulët drejtuese.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke filluar nga data 27 Prill 2017.

1-Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Te jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorie ekzekutive;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” profili Inxhinjeri.
- b) Të kenë 3 vjet përvojë pune në fushën përkatëse;
- c) Të ketë aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.
- ç) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) fotokopje të diplomës;
- c) fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

2-Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 28.04.2017, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe ne web site të Autoritetit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë e ulët drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Autoriteti, për shkaqet e moskualifikimit.

3-Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkursi:

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri në lidhje me legjislacionin e shërbimit civil;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri mbi VKM Nr. 292, date 2.05.2012 “Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike”.
- Njohuri mbi VKM Nr. 466, date 27.02.2013 “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

4-Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Testi me shkrim deri në 40 pikë.
- Intervistën e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën , deri në 40 pikë.
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit të parvjesës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

5-Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në website të Autoritetit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurrimit, do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Mediave Audiovizive, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Mediave Audiovizive mbas datës 28 Prill 2017.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi në Autoritetin e Mediave Audiovizive me Adresë: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.